



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 2369/ Prot.

Tiranë, më 03.10. 2019

VENDIM

Nr. 16 Datë 20.09. 2019

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR, PUS-SHPIM,
SHKOZË, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN "DRITAN ÇITOZI" Person Fizik,
PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE (LAVAZH)

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2013, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar, neni 41 pika 1 gërma "e", neni 50 pika 2, vendimit nr.416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221, datë 26.04.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.6, datë 16.02.2016, për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", neni 11 pika 3 dhe vendimit nr.6, datë 12.06.2019, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor", me propozim të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1. Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor nëntokësor (pus-shpim), për subjektin "Dritan Çitozi" person fizik, për qëllime teknologjike (lavazh), me vendodhje: Shkozë, Bashkia Tiranë, me këto të dhëna:

- Koordinatat e pusit (KRRGJSH): X 487818,17 Y 4577757,83 Z 148
- Kapaciteti i pusit: 0.001 m³/s
- Volumi maksimal i ujit që kërkohet: 0,0003 m³/s
- Thellësia totale e pusit 24 ml
- Diametri i pusit 600 mm
- Sasia e ujit që jepet në përdorim 0.0003 m³/s
- Qëllimi i përdorimit: Ujë teknologjik për "Lavazh"
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur: Rrjeti i kanalizimeve UK Tiranë


duke marrë parasysh arsyet e ndryshimit të thellësisë dhe diametrit të hapjes së pusit për shkak të llojit të shtresave ujëmbajtëse, të reflektuar në studimin hidrogjeologjik dhe miratuar nga openenca e SHGJSH –së.

2. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Anastasi Meçi



KRYETAR
Suzana Jahollari

